

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar
Financial Reporting**

P5

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 23.01.2021

1. Pasqyrat financiare në vijim kanë të bëjnë me Lassie sh.a dhe kompanisë në të cilën ka investuar, Rin Tin Tin sh.a

Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

	Lassie sh.a	Rin Tin Tin sh.a
	€ milion	€ milion
Të hyrat	900	300
Kosto e shitjeve	<u>(400)</u>	<u>(150)</u>
Fitimi bruto	500	150
Shpenzimet administrative	(170)	(60)
Kosto e shpërndarjes	(35)	(15)
Të ardhurat tjera	<u>20</u>	<u>-</u>
Fitimi para tatimit	315	75
Tatimi	<u>(30)</u>	<u>(15)</u>
Fitimi për vitin	285	60

Pasqyra e pozotës financiare me 31 dhjetor 2020

	Lassie sh.a	Rin Tin Tin sh.a
	€ milion	€ milion
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>		
Prona, fabrika & paisjet	600	260
Investimet	<u>400</u>	<u>30</u>
	1,000	290
<i>Pasuritë qarkulluese</i>		
Stoqet	80	35
Të arkëtueshmet tregtare	60	55
Paraja & banka	<u>20</u>	<u>10</u>
	<u>160</u>	<u>100</u>
Total pasuritë	1,160	390
<i>Ekuiteti</i>		
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	500	200
Premia e aksioneve	50	30
Fitimet e mbajtura	<u>520</u>	<u>90</u>
	1,070	320
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>		
Të pagueshmet tregtare	70	60
Tatimi	<u>20</u>	<u>10</u>
	<u>90</u>	<u>70</u>
Total ekuiteti & detyrimet	1,160	390

Informatat shtesë në vijim janë të rëndësishme:

- (i) Lassie sh.a bleu 80% të interesit në ekuitetin e Rin Tin Tin me 1 maj 2020. Kosto e investimit ishte €320 million, e paguar në para. Në datën e vlerjes, vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues në Rin Tin Tin sh.a ishte €100 million.

- (ii) Në datën e blerjes Rin Tin Tin sh.a kishte paisje të cilat kishin vlerë të drejtë prej €12 milion mbi vlerën e tyre bartëse. Në datën e blerjes paisjet kishin jetë të mbetur të përdorimit prej 4 viteve.
- (iii) Pas blerjes Rin Tin Tin shiti mallra tek Lassie sh.a for €12 milion. Rin Tin Tin fiton marzhë në çmimin e shitjes prej 25% për mallra të shitura tek Lassie sh.a. €4 milion prej këtyre mallrave sipas cmimit të shitjes të blerë nga Rin Tin Tin sh.a mbeten në stoqet e Lassie sh.a me 31 dhjetor 2020. Këto mallra ishin mallra të blerë në periudhën pas blerjes.
- (iv) Investimet e mbetura në librat e Lassie sh.a kanë të bëjnë më investime në ekuitet dhe kishin vlerë të drejtë prej €100 milion me 31 dhjetor 2020. Nuk është bërë një zgjedhje e parevokueshme sipas SNRF 9 në momentin e njohjes fillestare për të matur këto investime sipas vlerës së drejtë nepërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.
- (v) Me 31 dhjetor 2020, Rin Tin Tin sh.a kishte llogari të arkëtueshme nga Lassie sh.a në shumë prej €10 milion. E njëjta shumë ishte e përfshirë në shumën e llogarive të pagueshme të Lassie sh.a.
- (vi) Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues sipas vlerës së plotë (të drejtë).
- (vii) Me 31 dhjetor 2020 është kryer një test i dëmtimit të zerit të mirë dhe rezultoi që zëri i mirë është dëmtuar për €10 milion.
- (viii) Asnjëra kompani nuk ka paguar dividendë gjatë periudhës.
- (xi) Supozo që të të gjitha shpenzimet dhe të hyrat ndodhin njëtrajtësisht gjatë gjithë vitit përveç nëse udhëzohet ndryshe. Asnjëra kompani nuk ka emetuar aksione të reja gjatë vitit.

Rrumbullakëso vlerat në €0.1 milion më të përafërt.

Kërkohet:

- (a) **Pergatite, në pajtim me SNRF-të, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për grupin Lassie për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (10 pikë)**
- (b) **Pergatite, në pajtim me SNRF-të, pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare për grupin Lassie me 31 dhjetor 2020. (15 pikë)**

(Total: 25 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

a) **Lassie sh.a**
Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

	€ milion
100% Lassie sh.a + 100% Rin Tin Tin sh.a * 8/12	
Të hyrat (900 + (300 x 8/12) - 12 (L15))	1,088
Kosto e shitjes (400 + (150 x 8/12) - 12 (L15) + 1 (L15) +2 (L14))	<u>(491)</u>
Fitimi bruto	597
Shpenzimet administrative (170+ (60 x 8/12) + 10 (L11))	(220)
Kosto e shpërndarjes (35 + (15 x 8/12))	(45)
Të ardhurat tjera	20
Fitimi nga rimatja e pasurive financiare L17	<u>20</u>
Fitimi para tatimit	372
Tatimi (30 + (15 x 8/12))	<u>(40)</u>
Fitimi për vitin	332
Fitimi për vitin i atribuar te:	
Pronarët e prindit	226.8
Interesit jo-kontrollues L18	<u>5.2</u>
	332.0

(b) Lassie sh.a:

Pasqyra e pozotës financiare me 31 dhjetor 2020

	€ milion
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika & paisjet (600 + 260 +10 (L14))	870
Zëri i mirë L11	118
Investimet (400 + 30 - 320 +20 (L17))	<u>130</u>
	1,118
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet (80 + 35 -1 (L15))	114
Të arkëtueshmet tregtare (60 + 55 - 10(L16))	105
Paraja & banka (20 + 10)	<u>30</u>
	<u>249</u>
Total pasuritë	1,367
<i>Ekuiteti</i>	
Aksionet e zakonshme prej €1 secila	500
Premia e aksioneve	50
Fitimet e mbajtura L12	<u>561.6</u>
	1,111.6
Interesi jo-kontrollues L13	<u>105.4</u>
	1,217
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Të pagueshmet tregtare (70 + 60 -10 (L16))	120
Tatimi (20 + 10)	<u>30</u>
	<u>150</u>
Total ekuiteti & detyrimet	1,367

L11 - Zëri i mirë në blerjen e Rin Tin Tin sh.a		€ milion
Kosto e investimit		320
Vlera e IJK-së në blerje		100
Vlera e drejtë e neto pasurive në blerje:		
Aksionet e zakonshme	200	
Premia e aksioneve	30	
Fitimet e mbajtura (shih shënimin më poshtë)	50	
Korigjimi i vlerës së drejtë (L14)	<u>12</u>	<u>(292)</u>
Zëri i mirë		128
Humbja nga dëmtimi		<u>(10)</u>
Saldo në PKPF		118

Shënim: Fitimet e mbajtura të Rin Tin Tin sh.a në blerje llogariten nga informacioni i dhënë në pasqyrën e pozitës financiare. Fitimet e mbajtura në fund ishin €90 milion dhe gjatë vitit ishin €60 milion, pra fitimet e mbajtura në fillim ishin €30 milion. Data e blerjes ishte 4 muaj më vonë. Deri në atë datë 4/12 e fitimit të vitit ishte fituar ($4/12 \times 60 = 20$) dhe asnjë dividend nuk ishte deklaruar ose paguar. Prandaj, fitimet e mbajtura në datën e blerjes ishin $(30 + 20) = €50$ milion.

L12 - Fitimet e mbajtura	Lassie sh.a	Rin Tin Tin sh.a
	€ milion	€ milion
Sipas pyetjes	520	90
Para blerjes		(50)
Dëmtimi i zërit të mirë		(10)
Fitimi nga rimatja e vlerës së drejtë (L17)	20	
Zhvlerësimi shtesë (L14)		(2)
Fitimi i perealizar (L15)		<u>(1)</u>
		27
Qe i takon prindit ($80\% \times 27$)	<u>21.6</u>	
Saldo në PKPF	561.6	

L13 - Interesi jo-kontrollues	€ milion
VD në blerje (L11)	100
Pjesa e fitimeve të mbajtura të Rin Tin Tin sh.a ($20\% \times 27$)	<u>5.4</u>
Saldo në PKPF	105.4

L14 - Korigjimi i vlerës së drejtë	€ milion
Në blerje	12
Zhvlerësimi që nga blerja $12/4$ vite $\times 8/12 =$	<u>(2)</u>
Saldo në datën e raportimit në PPF	10

L15 - Tregtia ndër-grupore	€ milion
Total mallrat e tregtuara pas periudhës së blerjes	12
Fitimi në shitje = $12 \times 25\% =$	4

Fitimi i perealizuar 4 x 25%	1
L16 - Korighimi i saldove ndwrgrupore	€ milion
LL/A	(10)
LL/P	(10)
L17 - Investimet	€ milion
Fitimi nga rimatja e vlerës së drejtë (100 - 80)	20
L18 - Pjesa e fitimeve për vitin që i takon IJK-së	€ million
Fitimi sipas pyetjes	<u>60</u>
Pjesa pas blerjes 8/12 x 60	40
Dëmtimi i zërit të mirë L11	(10)
Zhvlerësimi shtesë	(2)
Fitimi i perealizuar nw tregtinw ndwr-grupore	<u>(1)</u>
F itimi i koriguar pwr vitin	27
IJK 20% x 27 =	5.2

2. Informatat në vijim kanë të bëjnë me pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse të Benji sh.a për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2020.

	€ milion
Shitjet	540
Kosto e shitjeve	<u>(300)</u>
Fitimi bruto	240
Shpenzimet operative	(100)
Kosto financiare	<u>(30)</u>
Fitimi para tatimit	110
Tatimi	<u>(14)</u>
Fitimi për vitin	96
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	<u>23</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse	119
Saldo tjera me 31 dhjetor 2020	€ milion
Kapitali aksionar (€0.50 secila)	200
Fitimet e mbajtura	90
Komponentët tjerë të ekuitetit	<u>220</u>
Total ekuiteti	1,210

Shënim:

- Nuk ka detyrime afatgjata.
- Divedidenda e paguar per vitin 2020 ishte 80 milion
- Cmimi për aksion €3.5

Kërkohet:

Llogaritni si në vijim:

- **Fitimin bazik për aksion** (2 pikë)
- **Dividenda për aksion** (2 pikë)
- **Rentabilitetin e dividendes** (2 pikë)
- **Koeficientin Ç/F** (2 pikë)
- **Marzhen e fitimit bruto dhe marzhen e fitimit neto** (2 pikë)
- **Kthimin në kapitalin e angazhuar, përfshire marzhen e fitimit dhe qarkullimin e pasurisë** (3 pikë)
- **Kthimi në ekuitet (KNE)** (1 pikë)
- **Mbulimi i interesit** (1 pikë)

(Total 15 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

Fitimin bazik për aksion

Fitimi për vitin/ Numri mesatar i ponderuar i aksioneve
 $96/400 = €0.24$

Dividenda për aksion

Dividenda për vitin/ Numri mesatar i ponderuar i aksioneve
 $80/400 = €0.20$

Rentabilitetin e dividendes

Dividenda për aksion/ Cmimi për aksion
 $€0.2/€3.5 = 5.71\%$

Koeficienti C/F

Cmimi për aksion/ Fitimin bazik për aksion
 $3.5/0.24 = 14.6$ here

Kthimin në kapitalin e angazhuar

Fitimi para interesit dhe tatimit / (kapitali i angazhuar)
 $140/1,210 = 11.6\%$

Marzha e fitimit

Fitimi para interesit dhe tatimit / shitjet
 $140/540 = 25.92\%$

Qarkullimi i pasurisë.

Shitjet / (kapitali i angazhuar)
 $540/1,210 = 44.63\%$

Marzhen e fitimit bruto dhe marzhen e fitimit neto

Fitimi bruto/shitjet;

$240/540 = 44.44\%$;

FPIT/shitjet

$96/540 = 17.77\%$

Kthimi në ekuitet (KNE)

$96/1,210 = 7.93\%$

Mbulimi i interesit

FPIT/ pagesat e interesit

$140/30 = 4.67$ here

3.

a) Hachikō sh.a ofron një garanci një vjeçare për pajisjet që ua shiste drejtpërdrejt klientëve. Në fund të vitit të kompanisë, ajo është paditur nga një prej klientëve të saj për refuzimin e riparimit të pajisjeve brenda periudhës së garancisë. Hachikō sh.a beson se riparimi nuk mbulohet nga garancia me arsyetimin se klienti nuk ka respektuar udhëzimet për përdorimin e pajisjeve.

Avokati i Hachikō sh.a ka këshilluar që ka më shumë të ngjarë që kompania të shpallet fajtores. Kjo do të rezultojë në kryerjen e kostove të riparimit, duke përfshirë shpenzimet ligjore që arrijnë afërsisht në €30,000.

Hachikō sh.a gjithashtu prodhon një linjë tjetër të pajisjeve të cilat i shet me shumicë. Hachikō sh.a shiti 4,000 artikuj të këtij lloji, përfshirë vitin e kaluar. Kjo pajisje gjithashtu ka një garanci riparimi një vjeçare. Bazuar në përvojën e kaluar, 10% e artikujve të shitur kthehen për riparim. Në secilin rast, 70% e artikujve të kthyer janë në gjendje të riparohen me një kosto prej €80, ndërsa 30% e mbetur kanë nevojë për riparim të konsiderueshëm me një kosto prej €250.

Kërkohet:

Tregoni dhe arsyetoni trajtimin korrekt në kontabilitetin të çështjeve të mësipërme në librat e Hachikō sh.a për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (10 pikë)

b) Boo sh.a është një kompani e madhe prodhuese. Kudo që është e mundur, ajo strukturon operacionet e saj për të përfituar nga çdo ndihmë financiare e disponueshme nga autoritetet kombëtare dhe rajonale. Gjatë vitit, Boo sh.a vendosi të zhvendosë disa nga operacionet e saj të tjera në një zonë të zhvillimit rajonal, e cila ofron kosto tërheqëse të punës dhe stimuj të tatimeve. Qeveria e ra dakord t'i dhurojë €200,000 si rezultat i vendosjes së Boo sh.a në zonën e zhvillimit rajonal. Nuk ka kushte të veçanta se për çfarë duhet të shpenzohen paratë. Paratë gatshme u morën më 1 gusht 2020.

Kërkohet:

Në përputhje me SNK 20 Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Shpalosja e Ndhmës Qeveritare shpjegojnë trajtimin në pasqyrat financiare të Boo sh.a të grantit të mësipërm për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020. (5 pikë)

c) Në përgjithësi të hyrat njihen kur entiteti ka transferuar mallrat ose shërbimet e premtuara tek klienti. SNRF 15 përcakton pesë hapa për procesin e njohjes.

Kërkohet:

Trego pesë hapat për njohjen e të hyrave sipas SNRF 15. (3 pikë)

d) Është e zakonshme për entitete për të pranuar grante qeveritare për qëllime të ndryshme (grantet mund të quhen subvencione, premi etj). Ato poashtu mund të marrin edhe lloje tjera të ndihmës e cila mund të jetë në formë të ndryshme. Trajtimi i granteve qeveritare mbulohet nga SNK 20 Kontabiliteti për grante qeveritare dhe shpalosja e ndihmës qeveritare.

Kërkohet:

Cilat janë dy metodat në dispozicion për trajtimin e granteve qeveritare të lidhura me pasuri? (2 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

(a) Trajtimi kontabël për transaksionet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

- Në fund të periudhës së raportimit, Hachikō sh.a konteston përgjegjësinë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh se ka më shumë të ngjarë që të konsiderohet fajtor, bazuar në këshillën e avokatëve, supozohet se ekziston një detyrim aktual.

Duke qenë se një detyrim i vetëm është duke u matur, bëhet një provizion për daljen e rezultatit më të mundshëm, d.m.th. një provizion njihet për €30,000.

- Një detyrim aktual ekziston në fund të periudhës së raportimit bazuar në evidencat historike të artikujve që riparohen sipas marrëveshjes së garancisë.

Këtu, një popullsi e madhe e artikujve është e përfshirë. Prandaj bëhet një provizion për vlerën e pritur të rrjedhave dalëse:

$4,000 \times 10\% \times 70\% \times €80$	€22,400
$4,000 \times 10\% \times 30\% \times €250$	<u>€30,000</u>
	€52,400

b)

- Kontributi prej €200,000 nga qeveria nuk varet nga ndonjë aktivitet i veçantë i entitetit.
- €200,000 duhet të kreditohen drejtpërdrejt në fitim ose humbje pasi nuk kompenson shpenzime specifike

- c)
- (i) Identifiko kontratën me klientin
 - (ii) Identifiko obligimet për performancë
 - (iii) Përcakto çmimin e transaksionit
 - (iv) Aloko çmimin e transaksionit tek obligimet për performancë
 - (v) Njahi të hyrat kur të (apo sipas) përmbushen obligimet për performancës
- d)
- Ekzistojnë dy zgjidhje se si duhet të paraqiten grantet e lidhura me pasuritë në pasqyrën e pozitës financiare (duke përfshirë edhe grantet jo-monetare me vlerë të drejtë.
- (a) Paraqitja e grantit si e ardhur e shtyrë.
 - (b) Zvogëlimi i grantit për të arritur në shumën bartëse të pasurisë.

4.

a) Chips sh.a bleu një makinë për përpunimin e ushqimit më 1 janar 2020. Kostoja totale e makinës arriti në €300,000. Me 31 dhjetor 2020, Chips sh.a vendosi të rivlerësojë makinerinë në €250,000 në përputhje me politikën e rivlerësimit të kompanisë.

Makineria zhvlerësohet me një normë vjetore prej 20% të kostos. Makineria gëzon lejime kapitale (zhvlerësim për qëllime tatimore) me një normë vjetore prej 25% të kostos.

Shkalla e tatimit mbi fitimi e aplikuar për Chips sh.a është 30%.

Drejtorët e Chips sh.a nuk kanë llogaritur ende detyrimin e shtyrë tatimor në lidhje me makinerinë e përpunimit në draft pasqyrat financiare për vitin deri në 31 dhjetor 2020. Aktualisht në draft pasqyrat financiare ekziston një pasuri e tatimit të shtyrë në shumën prej €5,000, shpenzimi i tatimit në fitim ishte €72,500 dhe përbërësit e tjerë të kapitalit ishin €12,000 me 31 dhjetor 2019.

Kërkohet:

Përgatitni ekstrakte të pasqyrave financiare të Chips sh.a për vitin deri në 31 dhjetor 2020, duke treguar trajtimin kontabël të tatimit të shtyrë. (8 pikë)

b) Saldot filestare të pasqyrës së ndryshimeve në ekuitet të Peritas sh.a me 1 janar 2020, ishin si në vijim:

Kapitali aksionar	Premia e aksioneve	Fitimet e mbajtura	Teprica e rivlerësimit	Total
€	€	€	€	€
500,000	300,000	225,000	120,000	1,145,000

Informacioni i mëposhtëm ishte i njohur më 31 dhjetor 2020:

- (i) 10,000 aksione prej 1 € ishin emetuar në 1 qershor 2020 me një premium prej €1.4 (€2.4 per aksion).
- (ii) Fitimet e mbajtura për vitin pas dividendëve prej €20,000 ishin €35,200.
- (iii) Toka u rivlerësua lart nga 45,000 gjatë vitit.
- (iv) Në 1 shkurt 2020, Peritas sh.a bëri një emision bonus 1 për 4, duke përdorur llogarinë e premisë së aksioneve.
- (v) Produktet prej €3,250 të shitura në 2019 dhe të përfshira në të hyrat për vitin 2020, ishin përfshirë gabimisht në stoqet përfundimtare me 31 dhjetor 2019 dhe stoqet në fillim me 1 janar 2020. Ky vlerësohet si një gabim.

Kërkohet:

Përgatite pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (12 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

a)

Chips sh.a	€'000
Detyrimet afatgjata	
Detyrim i tatimit të shtyrë (7.5L13 - 5)	2.5
Ekuiteti	
Komponentë të tjerë të ekuitetit 12 + (10L11 - 3L13)	19
Chips sh.a	
(ekstraktet) për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020	€'000
Tatimi në fitim (72.5 + 4.5 L13)	77
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse	
Përgitim nga rivlerësimi 10L11 - 3L13	7

Llogaritjet

L11

Llogaritja e vlerës bartëse	€'000
Kosto	300
Zhvlerësimi @ 20%	<u>60</u>
Vlera bartëse	240
Teprica e rivlerësimit	<u>10</u>
Shuma e rivlerësuar	250

L12

Llogaritja e bazës tatimore	€'000
Kosto	300
Lejimi kapital @ 25%	75
Baza tatimore	225

L13

Tatimi i shtyrë	€'000
Vlera bartëse	250
Baza tatimore	225
Diferencat e përkohshme të tatueshme	25
Detyrim i tatimit të shtyrë @30%	7.5
Alokimi:	
Komponentë të tjerë të ekuitetit (30% x 10L11)	3
Tek fitimi ose humbja (7.5 -3)	4.5

b)

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 për Peritas sh.a

	Kapitali aksionar	Premia e aksioneve	Fitimet e mbajtura	Teprica e rivlerësimit	Total
	€	€	€	€	€
Saldo me 1 janar 2020	500,000	300,000	225,000	120,000	1,145,000
Gabimi i periudhës së mëhershme			(3,250)		(3,250)
Saldo e riparaqitur	500,000	300,000	221,750	120,000	1,141,750
Emetimi i aksioneve	10,000	14,000	-	-	24,000
Dividendat	-	-	(20,000)	-	(20,000)
Fitimi për vitin	-	-	55,200*	-	55,200
Përfitimi nga rivlerësimi	-	-	-	45,000	45,000
Emetimi bonus 500,000 x 1/4	<u>125,000</u>	<u>(125,000)</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>-</u>
Saldo me 31 dhjetor 2020	635,000	189,000	256,950	165,000	1,245,950

5. Bilanci vertetues në vijim është i kompanisë Bretagne sh.a me 31 dhjetor 2020.

	€'000	€'000
Aksionet e zakonshme €0.5 secila		50,000
Premia e aksioneve		20,000
Fitimet e mbajtura me 1 janar 2020		11,200
Toka dhe ndërtesat –sipas kostos (toka €10 milion) (shënim (i))	60,000	
Fabrika dhe paisjet – sipas kostos (shënim i)	94,500	
Zhvlrësimi i akumuluar 1 janar 2020:		
Ndërtesat		20,000
Fabrika dhe paisjet		24,500
Shpenzimet e hulumtimit dhe zhvillimit (shënim (iv))	50,000	
Stoqet me 31 dhjetor 2020	43,700	
Të arkëtueshmet	42,200	
Banka		6,800
Tatimi i shtyrë (shënim (iii))		6,200
Të pagueshmet tregtare		35,100
Të hyrat (shënim (ii))		600,000
Kosto e shitjes	411,500	
Kosto e shpërndarjes	21,500	
Shpenzimet administrative	30,900	
Dividenda e paguar	20,000	
Interesi bankar	700	
Tatimi aktual (shënim (iii))	_____	<u>1,200</u>
	775,000	775,000

Shënimet në vijim janë të rëndësishme:

(i) Pasuritë jo-qarkulluese:

Me 1 janar 2020, drejtorët e Bretagne sh.a vendosën që pasqyrat financiare do të tregonin një pozitë të përmirësuar nëse toka dhe ndërtesat do të vlerësoheshin në vlerën e drejtë. Në atë datë, një vlerësues i pavarur e vlerësoi tokën me €12 milion dhe ndërtesat me €35 milion për herë të parë dhe këto vlerësime u pranuan nga drejtorët. Jeta e mbetur e përdorimit të ndërtesave në atë datë ishte 14 vjet. Bretagne sh.a nuk bën një transferim në fitimet e pashpërndara për zhvlrësimin e tepërt. Injoroni tatimin e shtyrë në tepricën e rivlerësimit.

Impiantet dhe pajisjet zhvlrësohen me 20% në vit duke përdorur metodën e saldoshës abritur dhe ndarjen e kohës siç është e përshtatshme. Të gjitha zhvlrësimet ngarkohen me koston e shitjeve, por asgjë nuk është ngarkuar akoma për ndonjë pasuri jo-qarkullues për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020.

Më 31 dhjetor 2020, u krye një rishikim i dëmtimit të impiantit dhe zbuloi se fabrika kishte vlerë në përdorim prej €52 milion dhe vlerë të drejtë minus kostot prej €48 milion.

(ii) Me 1 janar 2020, Bretagne sh.a shiti një prej produkteve të saj për €50 milion (përfshirë në shifrën e të hyrave në bilancin e mësipërm vertetues). Marrëveshja e shitjes kërkonte që Bretagne sh.a të siguronte servisimin e vazhdueshëm të produktit deri më 31 dhjetor 2022. E gjithë vlera e servisimit përfshihet në të hyrat në bilancin vërtetues.

Kostoja e vlerësuar e shërbimit për Bretagne sh.a është €3 milion në vit. Bretagne sh.a realizon një marzhë të fitimit bruto për një servis të tillë prej 20%. Injoroni skontimin.

- (iii) Bretagne sh.a vlerëson se një provizion i tatimit mbi të ardhurat prej €27.2 milion kërkohet për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 dhe në atë datë, detyrimi për tatimin e shtyrë është €9.4 milion. Lëvizja për tatimin e shtyrë duhet të ngarkohet në fitim ose humbje. Saldo e tatimit aktual në bilancin vertetues paraqet nën / mbi provizionim të detyrimit tatimor për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019.
- (iv) Shpenzimet për hulumtim dhe zhvillim të përfshira në bilancin e mësipërm vertetues përbëhen nga:
- €10 milion kosto hulumtimi e shpenzuar nga Bretagne sh.a për të hulumtuar përdorimin e mundshëm të sistemit të ri në operacionet e tij.
 - € 40 milion shpenzime për zhvillim të shpenzuara për zhvillimin e softuerit të sistemit që do t'i mundësojë Bretagne sh.a të zvogëlojë shpenzimet e saj operative.

Bretagne sh.a pret që sistemi të jetë në funksion për 5 vitet e ardhshme. Përdorimi tregtar i tij filloi më 31 shtator 2020.

- (v) Çfarëdo amortizimi duhet të ngarkohet te shpenzimet administrative.

Kërkohet:

- (a) **Përgatitni pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave e tjera gjithëpërfshirëse për Bretagne sh.a për vitin e përfunduar 31 dhjetor 2020. (10 pikë)**
- (b) **Përgatitni pasqyrën e pozitës financiare të Bretagne sh.a me 31 dhjetor 2020. (10 pikë)**

(Total: 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

a) Pasqyra e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse të Bretagne sh.a's për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020

	€'000
Të hyrat (600,000 - 7,500)	592,500
Kosto e shitjes (II5)	<u>(432,000)</u>
Fitimi bruto	160,500
Shpenzimet administrative (II5)	<u>(42,900)</u>
Kosto e shpërndarjes	<u>(21,500)</u>
Fitimi operativ	96,100
Kosto financiare	<u>(700)</u>
Fitimi para tatimit	95,400
Tatimi në fitim (26,000 + 3,200) II3	<u>(29,200)</u>
Fitimi për vitin	66,200
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:	
Teprica e rivlerësimit (II1)	7,000
Totatl të ardhurat gjithëpërfshirëse	73,200

b) Pasqyra e pozitës financiare të Bretagne sh.a me 31 dhjetor 2020

	€'000
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (II1)	96,500
Kosto e zhvillimit (II4)	<u>38,000</u>
	134,500
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	
Stoqet	43,700
Të arkëtueshmet	<u>42,200</u>
	<u>85,900</u>
Total pasuritë	220,400
<i>Ekuiteti dhe detyrimet</i>	
Ekuiteti	50,000
Premia e aksioneve	20,000
Teprica e rivlerësimit	7,000
Fitimet e mbajtura (11,200+66,200 -20,000)	<u>57,400</u>
Total ekuiteti	134,400
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Tatimi i shtyrë	9,400
Të hyrat e shtyera	<u>3,750</u>
	13,150
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Llogaritë e pagueshme	35,100
Të hyrat e shtyera	3,750
Tatimi i pagueshëm	27,200
Mbitërheqja bankare	<u>6,800</u>
	<u>72,850</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	220,400

Llogaritjet

1. Prona, fabrika dhe paisjet

	Toka	Ndërtesa	Fabrika & paisjet	Total
	€'000	€'000	€'000	€'000
kosto s/fillim	10,000	50,000	94,500	154,500
Minus zhvl. i akumuluar	-	<u>(20,000)</u>	<u>(24,500)</u>	<u>(44,500)</u>
Vlera bartëse s/fillim	10,000	30,000	70,000	110,000
Rezerva e rivlerësimit (saldo)	<u>2,000</u>	<u>5,000</u>	-	<u>7,000</u>
Rivlerësuar 1 janar 2019	12,000	35,000	70,000	117,000
Shpenzimet e zhvlerësimit	-	<u>(2,500)</u>	<u>(14,000)</u>	<u>(16,500)</u>
Vlera bartëse me 31 dhjetor 2020 para humbjes nga dëmtimi	12,000	32,500	56,000	100,500
Saldo			<u>(4,000)</u>	<u>(4,000)</u>
Vlerat bartëse me 31 dhjetor 2020	12,000	32,500	52,000	96,500

2. Të hyrat

Vlera e shitjes së shërbimeve

€3 milion x 3 vite x 100/80 = 11,250/ 3 vite =Vlera e shërbimit në vit 3,750

Detyrim afatshkurtë = 3,750

Detyrim afatgjatë = 3,750

Debi Të hyrat 2 vite vlerë shërbimi 7,500

Kredi Detyrim 7,500

3. Tatimi në fitim

Tatimi aktual

Provizionet për vitin 27,200

Minus mbi provizionimi (1,200)

Tek fitimi ose humbja 26,000

Tatimi i shtyrë

Saldo fillim 9,400

Minus saldo fund (6,200)

Tek fitimi ose humbja 3,200

Total tek F/H (26,000 + 3,200) 29,200

4. Huluntim dhe zhvillim

Kosto e hulumtimit prej 10,000 shpenzohet

Kosto e zhvillimit prej 40,000 kapitalizohet dhe amortizohet për 3 muaj nga tetori

Kosto 40,000

Amortizimi (40,000/5 vite x 3/12) (2,000)

Vlera bartëse 38,000

5. Shpenzimet operative

	Kosto e shitjes	Administrative	Shperndarjes
	€'000	€'000	€'000
Sipas pyetjes	411,500	30,900	21,500
Zhvlerësimi:			
Ndërtesat 35,000/14	2,500		
Fabrika	14,000		
Dëmtimi i fabrikës	4,000		
Amortizimi i K.Zh		2,000	
Kosto e hulumtimi		10,000	
	<hr/> 432,000	<hr/> 42,900	<hr/> 21,500